



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1127/4 prot.

Tiranë, më 16. 08. 2022

V E N D I M

Nr. 162, datë 16. 08. 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 121, datë 09.08.2022, të paraqitur nga ana e OJF-së ABC Tirana Club, kundër Ministrisë së Kulturës, lidhur me procesin e përzgjedhjes së fituesve të Thirrjes për projekte 2022, pa përcaktuar një shkak të pretenduar diskriminimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, subjekti ankues, ka parashtruar ndër të tjera se: “ABC Tirana Club është një OJF, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e vet, sipas legjislacionit në fuqi, (me shumë info në www.abctiranacub.wordpress.com apo në llogaritë e saj në FB, IG e YouTube). Organizata ishte një nga aplikuesit në garën e Thirrjes për projekt propozime, që shpalli Ministria e Kulturës për vitin 2022, mbështetur me një fond publik me vlerë mbi 1 milion euro. Më datë 12 shkurt 2022 Ministria e Kulturës shpalli në website-n e saj zyrtar një listë për projekt-propozimet fituese, ku nuk përfshihej ABC Tirana Club, e cila kishte garuar me projekt-propozimin që kishte target të rinjtë (15-17 vjeç) në bashkitë e Matit dhe Tepelenës.

Sapo u njohëm me këtë informacion të Ministrisë; me të drejtën e një prej garuesve të Thirrjes; pasi bëmë edhe një verifikim të të gjithë aplikimit që kishim dorëzuar në Ministri; por dhe nisur nga fakti se bëhej fjalë për përdorimin e fondeve publike, pra nga këto arsye dhe sigurisht duke mos qenë dakord me mospërfshirjen në listën fituese, ne i drejtuam një kërkesë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ministrisë së Kulturës, për të marrë më shumë informacion mbi mënyrën e vlerësimit të projekt propozimit tonë.

Pas kësaj, na vjen një shkresë zyrtare (datë 7 mars 2022, nr. prot. 865/1), e cila në fakt nuk kishte asnjë përgjigje konkrete mbi vlerësimin, veçse, sikundër do ta lexoni shkresën, kishte një premtim nga Ministria se dosja e ABC Tirana Club do “vazhdojë të konsiderohet dhe rishikohet, nëse në muajin qershor, me rishikimin e buxhetit, do të ketë shtesa dhe mundësi për mbështetje edhe të projekteve të tjera”.

Të pakënaqur me shkresën, ne adresuam një ankesë për Ministrinë e Kulturës, ku në esencë kërkohej sërish “informacion mbi vlerësimin e institucionit që drejtoni, jo vetëm si garues, por dhe si e drejtë që na lind nga respektimi i kërkesave të ligjit 44/2015 (Kodi i Procedurës Administrative).” Siç dhe do ta lexoni në rrjedhën e komunikimit zyrtar ABC Tirana Club - Ministri, që gjeni bashkëlidhur kësaj ankese, vjen një shkresë zyrtare po nga Sekretarja e Përgjithshme, (nr. prot. 865/3, datë 30.03.2022).

Në shkresën e Ministrisë ishin renditur tri arsye “negativiste”, se përse nuk ishte përfshirë në listën fituese ABC Tirana Club. Ju do i shikoni vetë arsyet, por ABC Tirana Club beson fort se, të trija janë thjeshtë justifikime për skualifikimin tonë pa të drejtë nga gara për përdorimin e fondit publik. Asnjëra prej tyre, siç ne kemi shpjeguar në ankesën 2 dhe në ankesën 3 nuk bazohet askund, as në ligj, dhe as në udhëzimin e Thirrjes që u bë publik po në të njëjtën kohë me Thirrjen. Ato janë 3 shkaqe subjektive të stisura nga Kolegjiumi që ka vendosur, se cili aplikues për Thirrjen do të ishte fitues dhe cili nuk do të ishte.”

Në vijim, subjekti ankues sqaron arsyet përse ABC Tirana Club mendon se është diskriminuar nga Ministria e Kulturës, duke parashtruar si më poshtë: “Grupi i studentëve aktivistë të ABC Tirana Club, që ndjek studimet për gazetari dhe komunikim (një pjesë e tyre janë aktivë dhe në media aktualisht), kanë bërë një hulumtim mbi listën e fituesve, sipas Ministrisë së Kulturës. Ata nuk kanë pasur akses në dokumentet që garuesit e shpallur fitues kanë dorëzuar në aplikim, por kanë shikuar (hulumtuar) profilin dhe veprimtarinë e OJF-ve, bazuar në publikimet që ata kanë bërë vet në hapësirat virtuale (website, rrjete sociale, raporte e studime të ndryshme etj).

Duke kuptuar që arsyet “negativiste” të Ministrisë ishin të sajara, qëllimi hulumtimit ishte nëse Kolegjiumi kishte vepruar njësoj edhe për OJF-të e tjera që ishin shpallur fitues. Hulumtimi ishte për asyen e tretë “negativiste” që artikulonte Ministria ndaj ABC Tirana Club, pra nëse OJF-të fituese e kishin artin, kulturën dhe trashëgiminë si qëllim dhe fushë kryesore të veprimtarisë së tyre. (Ju e shikoni se pas ankesës që bën organizata jonë një nga arsyet e moskualifikimit fitues ishte dhe se “në statusin e shoqatës tuaj, qëllimi dhe fusha kryesore e veprimtarisë nuk është arti, kultura dhe trashëgimia, por vendimarrja, reformat, korrupsioni, monitorimi i autoriteteve të qeverisjes”).

Ne, gjatë komunikimit ABC Tirana Club - Ministri, kemi treguar në mënyrë të përsëritur se është e shkruar në Statutin tonë dhe qëllimi për ... “edukimin kulturor të popullatës, veçanërisht të të rinjve, përmes njohjes dhe përhapjes së vlerave më të mira të kulturës kombëtare, traditës dhe historisë së popullit shqiptar, si dhe duke nxjerrë në pah shijet kulturore dhe artistike progresiste evropiane dhe në nivel global”. Kjo është e shkruar jo tani, por që në dokumentet e themelimit dhe miratimit nga gjykata të organizatës (2018). Ne e kemi jo vetëm të

shkruar këtë në Statut, por dhe e kemi bërë dhe me vepra gjatë këtyre viteve. Kemi kontribut dhe impakt konkret në një sërë aktivitesh të mirëfillta kulturore dhe artistike të organizuara, me përfshirjen e artistëve të rinj nga vendi, por dhe nga shtete të rajonit. (Ashtu siç kemi dhe kontribute dhe impakt konkret edhe në fusha të tjera, ku protagonistë janë po të rinjtë, integrimi evropian, ndryshimet klimatike, nxitja e nismave rinore dhe monitorimi vendimarrësve në nivel lokal e qëndror, mësimi në distancë i studimeve, edukimi ekonomik dhe financiar i publikut etj.)

Haptazi Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës ka përdorur dy standarde vlerësimi për garuesit e Thirrjes. Haptazi ka bërë selektim, diferencim, diskriminim. Hulumtimi që kemi bërë për profilin dhe aktivitetin e OJF-ve të shpallura fituese dha një të vërtetë të hidhur: Arsyeja “negativiste” për ABC Tirana Club, që për ne është totalisht, absurd, subjektiviste dhe e pabazuar në ligj dhe në udhëzimin e Thirrjes, se “në statusin e shoqatës tuaj, qëllimi dhe fusha kryesore e veprimtarisë nuk është arti, kultura dhe trashëgimia, por vendimarrja, reformat, korrupsioni, monitorimi i autoriteteve të qeverisjes” - në fakt është një formë e pastër diskriminimi. Sepse nga hulumtimi ynë vërtetohet se kjo arsye nuk është marrë në konsideratë për të paktën 22 OJF, të cilat Kolegjiumi i Ministrisë i ka përfshirë në listën fituese.

Për të paktën 22 OJF, vërtetohet sipas ABC Tirana Club, se, arti, kultura dhe trashëgimia nuk janë fusha kryesore të aktivitetit të tyre (sipas deklarimeve që vetë këto OJF bëjnë). OJF-të që ju tregojmë në listen më poshtë, nuk po themi se janë ilegjitime. Nuk po themi se nuk duhet të merren me kulturë, art, trashëgimi. Po themi se qëllimi dhe fusha kryesore e veprimtarisë nuk është arti, kultura dhe trashëgimia - një arsye “negativiste” që penalizoi ABC Tirana Club.

Më poshtë renditen (sipas numrit që kanë në listën publike që ka shpall Ministria e Kulturës) të 22 OJF-të, për të cilat ABC Tirana Club mendon se nuk e plotësojnë këtë arsye ‘negativiste’.

ABC Tirana Club mendon se Ministria e Kulturës përmes Kolegjiumit i ka diskriminuar, duke sqaruar se: “Ministria e Kulturës ka nisur diskriminimin ndaj ABC Tirana Club menjëherë sapo ka dërguar ankesa ndaj këtij institucioni për Thirrjen e projekt-propozimeve 2022. Ne jemi të bindur se ABC Tirana Club si një organizatë studentore, joqeveritare, qartazi është viktimë e një veprimi revanshi, një veprimi diskriminues të hapur nga Ministria, sapo janë adresuar ankesat ndaj saj.

Ne jemi të bindur se Kolegjiumi e ka injoruar aplikimin tonë. Sepse realisht ne nuk kemi pasur asnjë të metë, por kemi pasur një aplikim tërësisht të mbështetur në kërkesat e Thirrjes, të mbështetur në Udhëzimin e Thirrjes, një projekt-propozim konkret, në mbështetje të talentëve të reja në bashkitë e Matit dhe Tepelenës.

Pasi ne u ankuam ka filluar revanshi, duke shpikur arsye subjektiviste, absurd, të pabazuara askund në ligj dhe në Udhëzimin e Thirrjes. E keni parasysh, shpallen si arsye “në statusin e shoqatës tuaj, qëllimi dhe fusha kryesore e veprimtarisë nuk është arti, kultura dhe trashëgimia...” ndërkohë që për të paktën 22 OJF të tjera ky “kriter” as që është marrë në konsideratë (Ne po themi “në të paktën 22 OJF”, sepse ka OJF që janë shpallur fituese të cilat

nuk kane asnjë gjurmë online (as website, as llogari në rrjetet sociale, që kur fut emrin e tyre në motorët e kërkimit nuk del asnjë rezultat !?)

Në publikimet e Komisionerit, por dhe në përmbajtjet e kuadrit ligjor dhe n/nligjor që është në fuqi, përshkruhet qartë si një formë diskriminimi dhe viktimizimi, dmth akti si, “trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë “.

Kjo formë diskriminimi është ushtruar qartë nga Kolegjiumi i Ministrisë në rastin e aplikimit të ABC Tirana Club. Ne morrëm njërën prej arsyeve “negativiste” që ka artikuluar Kolegjiumi dhe që rezulton se ka qenë diferencuese, selektive se për të pakten 22 OJF kjo nuk është marrë parasysh. Pas ankesave që ka adresuar ABC Tirana Club, Ministria qartazi ka treguar revansh edhe duke hequr dorë dhe nga “premtimi” i persëritur (që për ne ka qenë farsë), se, dosja e ABC Tirana Club do “vazhdojë të konsiderohet dhe rishikohet, nëse në muajin qershor, me rishikimin e buxhetit, do të ketë shtesa dhe mundësi për mbështetje edhe të projekteve të tjera”).

ABC Tirana Club ka mendimin se po e njëjta gjë vlen dhe për 2 arsyet e tjera “negativiste”. Por për momentin ne nuk kemi akses në dokumentacionin që kanë dorëzuar në aplikim OJF e shpallura fituese, si dhe në kontratat e lidhura për zbatimet e projekteve. Ndaj për korrektesë në qendrim nuk po adresojmë asnjë pretendim të vërtetuar. Por grupi i aktivisteve tanë e ka në fokus këtë aspekt dhe po konsultohet për gjetjen e rrugëve ligjore (sidomos të drejtës për informim) për transparencë të mëtejshme.

Aktualisht kemi njoftuar Këshillin e Ministrave për problematikat që kemi me Ministrinë e Kulturës. Pas dy letrave që kemi nisur për sekretarin e përgjithshëm të KM, nuk kemi marrë ende përgjigje. Por ne nuk demotivohemi. Jemi të rinj dhe e dimë ku jetojmë. E dimë kasaphanën me fondet publike, për të cilën flet çdo raport dhe studim brenda e jashtë vendit.

Ndaj dhe po këmbëngulim dhe do të këmbëngulim me këtë rast konkret abuzimi me Kodin e Procedurës Administrative, por dhe si formë e pastër diskriminimi që e kanë deformuar garën për përdorimin e fondeve publike në kuadër të Thirrjes për projekt-propozime 2022.

ABC Tirana Club do të përdorë çdo hapësirë komunikimi dhe çdo partneritet që të tregojë se: vendimmarrja e Kolegjiumit të Ministrisë se Kulturës është e gabuar nga pikëpamja procedurale dhe administrative, sepse është e pabazuar në ligj dhe Udhëzimin e lëshuar po nga ky institucion, gjithashtu se, vendimmarrja e Kolegjiumit të Ministrisë është një formë e pastër diskriminimi ndaj ABC Tirana Club, si një nga garuesit e Thirrjes për projekt-propozime 2022.”

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e Kolegjiumit të Ministrisë se Kulturës ndaj ABC Tirana Club pa përcaktuar një shkak diskriminimi konkret.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe për

këtë, më datë 11.08.2022, u mor kontakt² me përfaqësuesin e ABC Tirana Club, duke i kërkuar plotësimin e saj.

Në përgjigje, subjekti ankues me shkresën³ datë 12.08.2022 informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: *“...ABC Tirana Club i qëndron përmbajtjes së ankesës me shkrim që i ka adresuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Organizata i qëndron shpjegimeve që ka përfshirë në ankesë, duke përsëritur argumentin thelbësor se, ne i drejtohem Komisionerit vetëm për pjesën e procesit ku mendojmë se Ministria e Kulturës na ka diskriminuar. Pasi për pjesën tjetër të shkeljeve procedurale dhe administrative ne jemi duke ndjekur një pistë tjetër.*

Në ankesën tonë ju kemi shpjeguar se, pas ankesës së parë (ka pasur në vijim dhe dy ankesa të tjera në adresë të Ministrisë së Kulturës), ka ndodhur diskriminim për ABC Tirana Club. Ministria na ka përmendur shkaqe të mospërfshirjes sonë në listën fituese të projekt propozimeve, të cilat sipas nesh janë subjektivist, të pabazuara në ligjin për kulturën, por as në udhëzimin e Thirrjes, udhëzimin që jep çdo term reference për kushtet që plotëson një aplikim, apo për kushtet që të skualifikojë nga gara e përdorimit të fondeve publike.

Ajo që ne kemi zbuluar nga hetimi ynë paraprak është fakti se Ministria e Kulturës jo vetëm që ka aplikuar ndaj ABC Tirana Club shkaqe “negativiste” skualifikimi të pabaza, por dhe që nuk janë marrë parasysh për subjektet e tjera aplikuese në garë. Ju kemi shpjeguar se shkaku “negativist” se, arti, kultura dhe trashëgimia nuk janë fusha kryesore të aplikantit ABC Tirana Club, Ministria nuk e ka marrë në konsideratë për të paktën 22 aplikantë të tjerë. Ky është selektiviteti, ky është diskriminimi për organizatën tonë.

E gjitha për mendimin tonë ka ardhur pas adresimit të ankesave. Është një reagim dëmtues për ABC Tirana Club nga Ministria e Kulturës nga shkaku ankesës. Ne mendojmë se pas kësaj ka filluar qëndrimi i disfavorshëm për organizatën që ka dhënë pasojë negative duke na eliminuar nga gara për një shkak, të cilin ne e kemi provuar paraprakisht se tek të paktën 22 aplikues nuk është marrë fare në konsideratë. (Nuk ka rëndësi numri 22, edhe sikur për 1 ose 2 të tilla të bëhej fjalë kjo do të ishte e papranueshme.)

Ju kemi shpjeguar se jemi në kushtet e formës së shtatë të diskriminimit që është viktimizimi, siç dhe përcaktohet, “trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë”.

Ne pretendojmë këtë formë diskriminimi nga Ministria, ndaj ju kemi adresuar me ankesë. Ne nuk marrim përsipër të pretendojmë për formë të tjera, pasi nga analiza komplekse që kemi bërë për rrethanat dhe faktet kjo na rezulton. Është e drejta e institucionit të Komisionerit të vlerësojë nëse kjo qëndron apo nuk qëndron...”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje*

² U mor kontakt me përfaqësuesin e ABC Tirana Club nëpërmjet telefonit.

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1127/2 prot., datë 12.08.2022

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁴, në nenin 3/1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 20, pika 1, të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”.

Në vijim të ndjekjes së procedurave ligjore, Komisioneri reflekton mbi vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesi është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁵. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁶.

⁴ Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

⁵ Neni 1, i ligjit 10221/2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁶ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferenat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “*çdo shkak tjetër*”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të tij.

Sa i takon pretendimit të subjektit ankues për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvehte.

Për sa më sipër, shkaku i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit, si dhe duhet vërtetuar me prova të mbështetura në fakte konkrete. Shkaku i diskriminimit në vetvete lidhet me një karakteristikë personale të ankuesit, e cila përbën pikënisje për reagimin e padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj tij. Subjekti ankues ka vënë në dukje se është diskriminuar për sa i përket, eliminimit nga gara në procesin e përzgjedhjes së fituesve të Thirrjes për projekte 2022 nga ana e Kolegjiut të Ministrisë së Kulturës, por ka identifikuar si shkak diskriminimi faktin që ka paraqitur ankesa kundër kësaj vendimmarrje pas skualifikimit në këtë garë. Në këtë situatë, evidentohet se ankesat e depozituara nga subjekti ankues janë paraqitur pas skualifikimit nga procesi i përzgjedhjes së fituesve të Thirrjes për projekte 2022.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një

karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilin subjekti ankues nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/b të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se “...është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 121 regj., datë 09.08.2022, të paraqitur nga ABC Tirana Club, kundër Ministrisë së Kulturës, pasi është e papajtueshme me dispozitat ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)